



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 tetor 2017
Nr. ref.:RK1129/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI70/16

Parashtrues

Fazli Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 185/2015, të 28 dhjetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Fazli Krasniqi nga Juniku (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 185/2015, të 28 dhjetorit 2015, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr.3202/12, të 6 marsit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Deçan, C. nr. 63/09, të 8 shkurtit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 185/2015, të 28 dhjetorit 2015, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtëpërdrejtë i marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 prill 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 11 maj 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 22 qershor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë formularin e kërkesës si dhe të kompletojë kërkesën e tij me dokumentacion relevant, gjegjësisht vendimet e gjykatave të rregullta.
8. Më 6 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës.
9. Më 20 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë vendimet e gjykatave të rregullta.
10. Më 27 korrik 2017, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrim të kërkesës.

11. Më 4 shtator 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 21 prill 2009, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Deçan, duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë në 1/2 të pjesës ideale të patundshmërive në ngastra të ndryshme kadastrale, të gjitha të evidentuara sipas fletës poseduese 391. Nga shkresat e lëndës rezulton që kjo masë trashëgimore është pjesë e trashëgimisë së vajzës së axhës së parashtruesit të kërkesës, përkatësisht e SH.K., të cilën e ka trashëguar nga paraardhësi i saj R.K., dhe e cila me vullnetin e saj të njëjtën e ka lënë trashëgimi për palët e tjera ndërgjyqëse (familjarë të parashtruesit të kërkesës, në cilësi të të paditurve në këtë procedurë gjyqësore). Në kërkesëpadi parashtruesi pretendonte se është në rend të njëjtë trashëgimorë sikurse palët tjera ndërgjyqëse.
13. Më 8 shkurt 2012, Gjykata Komunale në Deçan (Aktgjykimi C. nr. 63/09), refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë. Në aktgjykimin e saj, theksohet: *“Gjykata erdhi në përfundim dhe vërtetoi në mënyrë të padyshimtë, se paditësi ka pasur mundësi me kohë për të gjallë të paraardhësve të tyre t'i sqaroj këto raporte, se një marrëveshje rreth ndarjes së paraardhësve të ndërgjyqësve nuk është kontestuar, brenda një viti dhe një dite sipas rregullave juridike të së drejtës civile, por edhe sipas nenit 117 të LMD ku parashihet pushim i të drejtës për të kërkuar anulimin e kontratës së rrëzueshme nëse anulimi nuk kërkohet në afat prej një viti prej ditës kur të ketë marrë në dijeni pala për shkakun e rrëzueshmërisë”.*
14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimin C. nr. 63/09, të 8 shkurtit 2012, të Gjykatës Komunale në Deçan, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
15. Më 6 mars 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 3202/12), refuzon si të pabazuar ankesën e parashtruesit. Në këtë aktgjykim, theksohet se: *“gjykata e shkallës së parë me nxjerrjen e provave të nevojshme dhe në prezencë të fakteve jokontesuese drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe me vlerësimin e drejtë të provave, drejt ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadi është e pabazuar ... në arsyetimin e aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të mjaftuara juridike dhe faktike të bazuara në ligj të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë.”*
16. Kundër këtij aktgjykimi parashtruesi parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar ekzistimin e shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 28 dhjetor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 185/2015), refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit. Gjykata Supreme konkludoi se: *“Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar faktin se të paditurit janë në posedim dhe shfrytëzim të patundshmërisë lëndore mbi 30*

vite, të cilët janë në posedim e kanë vazhduar pas vdekjes së Sh. K., në vitin 1985, e cila ka jetuar deri në momentin e vdekjes në bashkësi familjare me të paditurit, e të cilin fakt nuk e ka kontestuar as paditësi deri në ditën e paraqitjes së padisë [...] Për këto arsye u vlerësuan si të pabazuara pretendimet e paraqitura në revizion”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) si dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1, të KEDNJ-së.
19. Parashtruesi më tej pretendon se: *“Aktgjykimi i Gjykatës Komunale përmban shkelje të rënda të dispozitave të procedurës kontestimore [...] nga se aktgjykimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos për shkak se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është kontradiktor me arsyet, përkatësisht aktgjykimi i atakuar nuk ka arsye për faktet vendimtare”*. Parashtruesi po ashtu pretendon se edhe Gjykata e Apelit me aktgjykimin e saj gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale.
20. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 185/2015, të 28 dhjetorit 2015, Aktgjykimin Ac. nr. 3202/12, të 6 marsit 2015 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan, C. nr. 63/09, të 8 shkurtit 2012.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
23. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

24. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.”

25. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor. Megjithatë, Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe të parapara në rregullin 36 të Rregullores së punës.
26. Gjykata sjell në vëmendje se parashtruesi i kërkesës pretendon se, duke ia refuzuar si të pabazuar kërkesën për vërtetimin e pronësisë, vendimet e gjykatave të rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, për shkak të vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimeve të gabuara ligjore.
27. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 185/2015, i 28 dhjetorit 2015, adresoi dhe vendosi për pretendimet e lartpërmenduara, të cilat tashmë ishin ngritur në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet këtij Aktgjykimi të Gjykatës Supreme, i cili konkludoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave ligjore, duke theksuar se: *“[...] gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtës materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar”.*
29. Gjykata Supreme, më tej, arsyetoi se: *“dispozitivi i aktgjykimeve të dy gjykatave është i qartë kur me ta është vendosur për kërkesëpadinë e paditësit, respektivisht ankesën, se në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, i cili arsyetim nuk është në kundërshtim me përmbajtjen e provave nga shkresat e lëndës”.*


30. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurave në gjykatat e rregullta, duke kontestuar vlerësimin e provave dhe vërtetimin e fakteve nga ana e këtyre gjykatave.
31. Gjykata rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, sikundër edhe interpretimet përkatëse ligjore, hyjnë brenda funksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e standardeve dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe për këtë arsye nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (shih: rastet e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 21893/93, 16 shtator 1996, paragrafi 65. Rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmërinë, i 5 prillit 2012).
32. Gjykata thekson se detyrë e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
33. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi kishte mundësi që të nxjerrë argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte relevante për rastin e tij dhe të kontestojë argumentet dhe dëshmitë e paraqitura kundër tij; se të gjitha argumentet dhe dëshmitë që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar drejt nga gjykatat. Rrjedhimisht, rezulton se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], aplikacioni nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
34. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtën e garantuar me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtruesi.
35. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje se vetëm përmendja e neneve përkatëse të Kushtetutës, me pretendimin se ato janë shkelur pa dhënë shpjegime të mëtajme se si erdhi deri te këto shkelje, nuk mjafton për të ngritur një pretendim të mbështetur për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
36. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk ka arritur të argumentojë dhe të dëshmojë në baza kushtetuese se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, ishin të padrejta apo arbitrare apo që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur.
37. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2017, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Bekim Sejdiu

Gjyqtari raportues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi